

VENDIM
Nr. 721, datë 20.11.2024

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES, NDËRMJET KËSHILLIT TË
MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË
REPUBLIKËS SË NIKARAGUAS, PËR PËRJASHTIMIN E VIZAVE PËR
PASAPORTAT E ZAKONSHME, DIPLOMATIKE DHE TË SHËRBIMIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 19, të ligjit nr. 43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Nikaraguas, për përjashtimin e vizave për pasaportat e zakonshme, diplomatike dhe të shërbimit, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

MARRËVESHJE
NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE
QEVERISË SË REPUBLIKËS SË NIKARAGUAS
PËR PËRJASHTIMIN E VIZAVE PËR PASAPORTAT E ZAKONSHME,
DIPLOMATIKE DHE TË SHËRBIMIT

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës së Nikaraguas (në vijim të referuara si “Palët”),

Duke synuar vazhdimin e zhvillimit të marrëdhënieve diplomatike ndërmjet “Palëve”, me synimin për një politikë migracioni të rregullt, ligjore, të sigurt, e cila është koherente me zhvillimin social, politik dhe ekonomik të të dyja vendeve,

Duke pranuar se shtetasit e Republikës së Nikaraguas janë të përjashtuar nga kërkesa për vizë kur udhëtojnë në Republikën e Shqipërisë për një periudhë jo më shumë se 6 muaj, ndërsa shtetasit shqiptarë i nënshtrohen kërkesës për vizë,

Duke ruajtur parimin e trajtimit të barabartë të qytetarëve të të dyja palëve,

Kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1
Qëllimi

Kjo Marrëveshje përcakton përjashtimin nga viza për shtetasit e Republikës së Shqipërisë dhe për shtetasit e Republikës së Nikaraguas kur udhëtojnë në territorin e Palës tjetër Kontraktuese për një periudhë maksimale prej 90 (nëntëdhjetë) ditësh, e cila mund të zgjatet deri në përfundimin e një periudhe prej 180 (njëqind e tetëdhjetë) ditësh.

Neni 2
Fushat e zbatimit

1. Qytetarët e “Palëve” Kontraktuese, të cilët janë mbajtës të pasaportave diplomatike, zyrtare, të shërbimit dhe të zakonshme, do të përjashtohen nga detyrimi për të marrë vizë për qëllimin e hyrjes në territorin e Palës tjetër Kontraktuese për një vizitë ose qëndrim gjatë një periudhe maksimale prej 90 (nëntëdhjetë) ditësh, e cila mund të shtyhet deri në përfundimin e një periudhe prej 180 (njëqind e tetëdhjetë) ditësh.

2. Shtetasit e “Palëve” kontraktuese do të hyjnë, kalojnë transit, qëndrojnë përkohësisht në dhe largohen nga territori i Palës tjetër Kontraktuese përmes të gjitha pikave kufitare të hapura për trafikun ndërkombëtar dhe ndërshtetëror, me kusht që të zotërojnë një dokument udhëtimi të vlefshëm.

3. Shtetasit e secilës prej “Palëve” kontraktuese do të hyjnë, kalojnë transit, qëndrojnë përkohësisht në dhe largohen nga territori i cilësdo prej Palëve Kontraktuese për periudhën e parashikuar në paragrafin 1 të këtij neni, pa tarifa dhe taksa.

4. “Palët” kontraktuese do të shkëmbejnë, me anë të rrugëve diplomatike, modelet e dokumenteve të tyre të vlefshme të udhëtimit të përcaktuara në paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë pas datës së hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.

5. Kur njëra nga Palët Kontraktuese lëshon një model të ri të dokumentit të udhëtimit ose modifikon ato tashmë të shkëmbyera, Pala tjetër Kontraktuese do të njoftohet për këto modifikime përmes rrugëve diplomatike 15 (pesëmbëdhjetë) ditë përpara datës së zbatimit të dokumentit ose modifikimit të ri. Njoftimi duhet të përfshijë një model të dokumenteve të reja ose të modifikuara dhe informacion mbi zbatueshmërinë e tyre.

6. Qytetarët e “Palëve” Kontraktuese, të cilët gjatë qëndrimit të tyre në territorin e Palës tjetër Kontraktuese, kanë humbur pasaportën ose një dokument tjetër udhëtimi zëvendësues, duhet të informojnë menjëherë autoritetet lokale përkatëse, të cilat do të lëshojnë një dokument që mbështet njoftimin.

7. Qytetarët e “Palëve” që hyjnë për të kryer një aktivitet të paguar gjatë qëndrimit të tyre nuk mbulohen nga kjo Marrëveshje, dhe për këtë arsye, për këtë kategori detyrimi i vizës ose përjashtimi për aksesin në punësim, do të vazhdojnë të aplikohen rregullat përkatëse kombëtare të secilit vend kontraktues.

Neni 3

Kohëzgjatja e qëndrimit

1. Shtetasit e Republikës së Shqipërisë do të qëndrojnë në territorin e Republikës së Nikaraguas për një periudhë maksimale prej 90 (nëntëdhjetë) ditësh, e cila mund të zgjatet deri në përfundimin e një periudhe prej 180 (njëqind e tetëdhjetë) ditësh pas datës së hyrjes së parë në territorin e vendit.

2. Shtetasit e Republikës së Nikaraguas do të qëndrojnë në Republikën e Shqipërisë për një periudhë maksimale prej tre muajsh (90) ditësh, e cila mund të zgjatet deri në përfundimin e një periudhe prej 180 (njëqind e tetëdhjetë) ditësh pas datës së hyrjes së parë në territorin e vendit.

3. Kjo Marrëveshje nuk cenon mundësinë që “Palët” të zgjasin periudhën e qëndrimit përtej tre muajsh për qëllime studimi, punësimi, bashkimi familjar, ndër të tjera, në përputhje me legjislacionin kombëtar të “palëve”.

4. Secila Palë Kontraktuese mund të refuzojë hyrjen ose të ndërpresë qëndrimin në territorin e saj të shtetasve të Palës tjetër Kontraktuese që i çmon të papranueshëm ose mund të përbëjnë një kërcënim në përputhje me legjislacionin e saj kombëtar.

Neni 4

Dispozitat përfundimtare

1. Kjo Marrëveshje do të miratohet nga “Palët” në përputhje me procedurat e tyre të brendshme përkatëse dhe do të hyjë në fuqi 30 (tridhjetë) ditë nga data e marrjes së njoftimit të fundit me shkrim, nëpërmjet rrugëve diplomatike, me anë të të cilit “Palët” kontraktuese kanë njoftuan njëra-tjetrën për procedurat për hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshje kur ajo të jetë përfunduar.

2. Kjo Marrëveshje do të mbetet në fuqi për një periudhë të pacaktuar. Secila nga “Palët” mund ta ndërpresë këtë marrëveshje tërësisht ose pjesërisht me një njoftim me shkrim (notë diplomatike) ndaj palës tjetër dhe ajo do të pushojë së qeni në fuqi pas 90 ditësh pas njoftimit.

Pala Kontraktuese që ka promovuar përfundimin e plotë ose të pjesshëm të zbatimit të kësaj Marrëveshjeje, do të informojë menjëherë Palën tjetër Kontraktuese me anë të rrugëve diplomatike për arsyen e pezullimit.

3. Kjo Marrëveshje mund të modifikohet me miratimin me shkrim të “Palëve”. Modifikimet do të hyjnë në fuqi sipas procedurave të brendshme të palëve.

4. Çdo mosmarrëveshje që lind ndërmjet “Palëve” nga interpretimi ose zbatimi i kësaj Marrëveshjeje, do të zgjidhet nëpërmjet konsultimeve dhe negociatave.

Nënshkruar në Nju-Jork, më 26.9.2024, në gjuhën shqipe, spanjolle dhe angleze, ku të gjitha tekstet janë njëloj autentike. Në rast të mospërputhjes në interpretim, teksti në gjuhën angleze do të ketë përparësi.

PËR KËSHILLIN E MINISTRAVE TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

PËR QEVERINË E REPUBLIKËS SË
NIKARAGUAS